



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME  
Zyra e Kryetarit/Sektori për Financa



Nr. Prot. 496

Datë: 2. 9. 2019

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, nr.01-060/01-24123/19 datë 21. 8. 2019, Npi-01/245, të datës 30. 8. 2019, për të nxjerrë në diskutim publik **Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2020**, Nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Zyra e Kryetarit/Sektori i Financave shpallë këtë:

**NJOFTIM PËR DEBAT PUBLIK ME QYTETARË**

**PLANI BUXHETOR I KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2020**

Njoftojmë qytetarët e komunës së Shtimes, se Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 8. 2019, ka marrë vendim që të nxjerrë në Diskutim Publik **Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2020**.

Duke u bazuar në këtë vendim të Kuvendit, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, organizojnë **Diskutimin Publik** (debat me qytetarë) sipas orarit në vazhdim:

Më datën, **13. 9. 2019** (ditë e **premtë**), këto takime mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës.

Në ora **10:00** - **Diskutimin Publik me Subjekte Politike;**

Në ora **11:00** - **Diskutimin Publik me Klubet e Biznesit;**

Në ora **14:00** - **Diskutimin Publik me Shoqërinë Civile dhe Klubet Sportive;**

Në ora **15:00** - **Diskutimin Publik me qytetarët e Shtimes, (Bashkësitë: I, II, III, IV dhe V);**

Më datën, **16. 9. 2019** (ditë e **hënë**),

Në ora **15:00** - **Diskutimin Publik me qytetarët e fshatrave Muzeqinë, Vojnovc, Gjyrkoc, Gllavicë dhe Rashincë ; ( Në shkollën fillore “Lasgush Poradeci”, në Muzeqinë)**

Në ora **16:30** - **Diskutimin Publik me qytetarët e fshatrave Petrovë dhe Mollopolc ( Në shkollën fillore “Bajram Curri”, në Petrovë),**

Në ora **18:00** - **Diskutimin Publik me qytetarët e fshatrave Carralevë, Pjetërshticë, Zborc, Rancë ( Në shkollën fillore “Abdullah Shabani”, në Carralevë),**

Në ora **19:30** - **Diskutimin Publik me qytetarët e fshatrave Godanc i Epërm, Godanc i Ulët dhe Lagje e Pajtimit ( Në shkollën fillore “Hasan Prishtina”, në Godanc),**

Debatet me Qytetarë dhe subjekte tjera do të mbahen në ndërtesën e Komunës së Shtimes, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftojmë qytetarët e Komunës së Shtimes, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, shoqërinë civile dhe të tjerët që të kontribuojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë debat.

**Draft- Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2020** për Komunën e Shtimes mund ta shkarkoni nga uebfaqja zyrtare e komunës: [kk.rks-gov.net/shtime](http://kk.rks-gov.net/shtime) ose mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Financa nr.23.

Kryetari i Komunës, Naim Ismajli

